



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 116/3 prot.

Tiranë më 7.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 7.02.2019

PËR KONTROLLUESIN “AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE ”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.18 datë 23.01.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, me objekt:

- Zbatimi i nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është një institucion publik i pavarur, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jo bankar dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin <http://www.amf.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në “Politikat e Privatësisë”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr.9887/2008: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të*

dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...” dhe Vendimit nr. 6/2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.

2. Konstatohet se kontrolluesi informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave “nëpunës”, “vizitorë”, etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) megjithatë, tabelat nuk janë në përputhje me formatin e miratuar sipas Udhëzimit nr.3 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”. Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj. Konstatimi sa i përket informimit jo të plotë të subjekteve të të dhënave, mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave, ushtrimit të të drejtave, të drejtën e ankimit etj., gjatë përpunimit e të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV) nga kontrolluesi, përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit nr.3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por kërkuan kohë për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet “Politikës së Privatësisë” në portalin zyrtar <http://www.amf.gov.al>.
2. Kontrolluesi “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), sipas standardit të parashikuar në Udhëzimit nr.3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.
3. Kontrolluesi “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmeshja e

këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.

4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 7.02.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

